

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. K. nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2037-/16 të datës 07.11.2016, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KP-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Musli Gashi dhe të akuzuarit, me datë 01.11.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë::

### AKTGJYKIM

#### I akuzuari:

L. K., nga i ati H., e ëma B., e vajzërisë G., i lindur me ( ), në Prizren, ku edhe tani jeton, në rr. " ", nr. , ka të kryer shkollën mesme, punëtor, i martuar, i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal .

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 09.06.2016, rreth orës 12:50 minuta, në rrugën " ", në Prizren, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerzëve dhe pasurin, në atë menyrë që duke vepruar në kundërshtim me nenin 150 të LSKRR-së, duke mos patur kujdesin e shtuar brenda vendëbanimit dhe duke mos ia përshtatur shpejtësin e lëvizjes së automjetit kushteve, gjendjes dhe rrethanave në rrugë, duke drejtuar automjetin e markës "VW Golf 2", me targa të regjistrimit , kur vije në vendin kritik, me pjesën e përparme të automjetit godet kombësozin M. R., i cili përplasat në asfalt, me ç'rast i dëmtuari, pëson lëndime të lehta trupore dhe atë: kontuzione në kokë, qafë dhe karahë si dhe dërmishje në bërnylin e majtë dhe dy shuplakat e duarve, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.N: H., të dt. 05.10.2016.

**-Këso dore kryen veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KP-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7,17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 dhe nenin 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I akuzuari L. K., obligohet që t' i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën mjekoligjore shumë prej 20.00 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 40.88 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari M... (N...) R... nga fshati K... Komuna e Prizrenit, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

### Arsyetim

Prokurori i Shtetit në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën, PP/II.nr.2037-7/16 të datës 07.11.2016, kundër të akuzuarit L... K... nga Prizren, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KP-së. Pas leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka përmirësuar, ashtu që në çdo faqe të saj në vend të mbiemrit të dëmtuarit R... duhet të jetë mbiemri R...

Në shqyrtimin fillestar, i akuzuari L... K... ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.


Gjykata në shqyrtimin fillestar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari L... K..., me datë 09.06.2016, rreth orës 12:50 minuta, në rrugën "...", në Prizren, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerzëve dhe pasurin, në atë menyrë që duke vepruar në kundërshtim me nenin 150 të LSKRR-së, duke mos patur kujdesin e shtuar brenda vendëbanimit dhe duke mos ia përshtatur shpejtësin e lëvizjes së automjetit kushteve, gjendjes dhe rrethanave në rrugë, duke drejtuar automjetin e markës "VW Golf 2", me targa të regjistrimit..., kur vije në vendin kritik, me pjesën e përparme të automjetit godet kombësorin M... R... i cili përplasat në asfalt, me ç'rast i dëmtuari, pëson lëndime të lehta trupore dhe atë: kontuzione në kokë, qafë dhe karahë si dhe dërmishje në bërrylin e majtë dhe dy shuplakat e duarve, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.N... H..., të dt. 05.10.2016.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari L... K..., i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, sepse gjatë pranimit të fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pa kushtëzim nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, për të cilat i akuzuari ka qenë i njëftuar me kohë dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, në gjykim ka patur qëndrim-tejet-korrekt para gjykatës, ka shprehur keqardhje për rastin dhe gjithashtu gjykata mori parasysh edhe raportet e tij të mira me të dëmtuarin ku edhe shoqrohen në mes veti, poashtu se i njëjti është familjar, baba i dy fëmijëve. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe në të ardhmen do ta parandaloj në kryerjen e veprave penale.




Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.2431/2016, me datë 01.11.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Luljeta Luboteni**



**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Sadije Selmani**



**UDHËZIM JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka-të-drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.